

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin /L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	214-25-3033-5-1-1
------------------------------	--------------------------

Sa i përket tenderit për: **Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"NIKA Pro-ing"sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

70000

(Kodi postar)

044 249 864

(Numri Telefonit)

N/A

Shpend Musa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Numri i Faks-it)

nika.proing@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.03.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 05.05.2025

Hapja e ofertave: 16.06.2025

1.Njoftimi mbi vendimin e AK: 27.08.2025-(rekomandohemi ne për kontratë)

2.Njoftimi mbi vendimin e AK: 10.02.2026

Kërkesa për rishqyrtim:16.02.2026

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: 24.02.2026

Ankesa në OSHP: 06.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Proces verbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 16.02.2026.

Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 24.02.2026, duke mos e dhënë asnjë arsyetim konkret se përse pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi: Ky nen përcakton qëllimin e ligjit, i cili është të rregullojë procedurat për prokurimin publik në mënyrë të drejtë, transparente dhe konkurruese.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorim sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike gjatë procesit të prokurimit.

Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi: Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa diskriminim në asnjë fazë të procedurës së prokurimit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Përcakton rregullat dhe kriteret për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale: Kërkesat për dëshmimin e aftësive teknike dhe profesionale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të qenë të kualifikuar për kontratën përkatëse.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit operativ për prokurim publik.

Mund të thuhet se gjatë procedurës të ri-vlerësimit, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Historia e procedurës së aktivitetit në fjalë

Parashtruesi i kërkesës për ri-shqyrtim, **Nika Proing**, ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me objekt **“Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare”**, me numër prokurimi **214-25-3033-5-1-1**, të inicuar në procedurë të hapur nga **Ministria e Punëve të Brendshme**.

Në këtë procedurë, ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës, kemi përmbushur në mënyrë të plotë të gjitha kriteret kualifikuese dhe kriterin vlerësues të specifikuar në Dosjen e Tenderit.

Më datë 27.08.2025, Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës së e-prokurimit, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës, duke na rekomanduar neve si Operator Ekonomik për lidhje të kontratës.

Pas paraqitjes së ankesës nga një Operator Ekonomik tjetër, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim tek Autoriteti Kontraktues. Pas përfundimit të rivlerësimit, është evidentuar një ndryshim i pajustificuar dhe kontradiktor i qëndrimit të Autoritetit Kontraktues, duke rekomanduar për lidhje të kontratës një Operator Ekonomik pavarësisht se ai kishte qenë i papërgjegjshëm në fillim.

Çuditërisht AK del në kundërshtim me veten e saj pasi OE që ishte i eliminuar më parë tani rekomandohet për kontratë!!!!

Në përputhje me nenin 7 të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës, ku AK ka ofruar qasjen.

Gjatë analizimit në dokumentacionin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të **eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit**.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar për secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1- GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm dhe duhet eliminuar automatikisht ngase ka manipuluar me çmime

Argumenti ynë:

Nga provat dhe dokumentacioni i siguruar gjatë procesit të tenderit, krijohet dyshim i arsyeshëm dhe serioz për favorizim të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, si dhe për veprime kundërtënëse dhe arbitrare nga Autoriteti Kontraktues.

Në vlerësimin fillestar, Komisioni i Vlerësimit dhe Zyra e Prokurimit pranë Ministria e Punëve të Brendshme kanë konstatuar qartë manipulim me çmime nga ana e Operatorit Ekonomik të rekomanduar, konkretisht në mbi 57 pozicione me çmime dukshëm më të larta, duke cenuar parimin e ekonomicitetit dhe konkurrencën e drejtë.

Këto konstatime janë përforcuar edhe nga ekspertja e angazhuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, e cila ka evidentuar të njëjtën praktikë të manipuluar me çmime nga Operatori Ekonomik i rekomanduar, duke konstatuar se në 57 pozicione janë ofruar çmime dukshëm më të larta krahasuar me çmimet reale të tregut.

Kjo strukturë përbën indikator klasik të manipulimit të ofertës, përmes:

- ofertimit strategjik të çmimeve të ulëta në pozicione të caktuara për efekt renditjeje,
- kompensimit përmes rritjes artificiale të çmimeve në shumicën e pozicioneve tjera.

Mosanalizimi serioz i kësaj strukture përbën dështim në mbrojtjen e interesit financiar publik.

Përkundër këtyre konstatimeve profesionale dhe zyrtare, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë vendimmarrje kundërtënëse, duke rekomanduar për kontratë të njëjtin Operator Ekonomik, pa arsyetim të ligjshëm dhe pa mbështetje në prova të reja materiale. Ky veprim përbën devijim flagrant nga parimet e barazisë, transparencës, konkurrencës së drejtë dhe ekonomicitetit, dhe krijon dyshim të arsyeshëm për favorizim të Operatorit Ekonomik.

Vendimmarrja e tillë është arbitrare, juridikisht e cenueshme dhe përbën shkelje të rëndë të procedurës së prokurimit publik, duke krijuar bazë të fortë për anulimin e vendimit dhe rikthimin e procesit në një rivlerësim të ligjshëm, objektiv dhe në përputhje me kriteret e Dosjes së Tenderit.

Oferta e GOE që autoriteti kontraktues ka rekomanduar përmban 57 pozicione me çmime dukshëm më të larta se të tjerët, ndërsa disa pozicione janë të ulëta vetëm për të krijuar një pamje që çmimi total është më i ulët.

Në vlerësimin fillestar të tenderit, ne Nika Proing, jemi rekomanduar për lidhje të kontratës, ndërsa Operator i Ekonomik i tashmë i rekomanduar për kontratë ishte eliminuar nga procedura për shkak të çmimeve dukshëm të larta në shumë pozicione.

Pas rivlerësimit, pa u paraqitur analiza të reja faktike dhe pa evidencë të re konkrete të tregut, AK ka ndryshuar plotësisht qëndrim.

Kjo situatë tregon një kontradiktë të qartë dhe të papërgjegjshme në vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktues gjatë rivlerësimit, duke ngritur dyshime serioze për favorizim të qëllimshëm të Operatorit Ekonomik të rekomanduar, në kundërshtim me parimet e transparencës, konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues ka interpretuar gabimisht vendimin e OSHP, sepse vendimi i OSHP për ri-vlerësim nuk nënkupton se rezultati fillestar ndryshohet, por është thjesht një kontroll procedural për verifikimin e korrektesisë dhe përputhshmërisë me kriteret e shpallura. Çdo veprim që tejkalon këtë kuadër procedural përbën shkelje të rregullave të tenderit dhe nuk ka bazë ligjore për ndryshimin automatik të fituesit ose të listës së ofertuesve të përzgjedhur.”

Autoriteti kontraktues duhet të ofrojë arsye konkrete dhe dokumente që shpjegojnë pse OE që ishte i eliminuar më parë tani rekomandohet për kontratë. Pa këtë, vendimi mund të konsiderohet shkelje e LPP-së.

GOE i rekomanduar për kontratë është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 2 - GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me certifikatat për Siguri dhe Shëndet në Punë .

Argumenti ynë:

Manipulim i mundshëm i dokumentacionit dhe certifikatave për Siguri dhe Shëndet në Punë

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm lidhur me dokumentacionin për Siguri dhe Shëndet në Punë. Gjatë analizimit të dokumentacionit kemi identifikuar mospërputhje të rëndë në certifikatat e paraqitura për punonjësit me inicialet L.Z., E.R. dhe Q.R., ku, trajnimi rezulton të jetë mbajtur më 07.04.2024, ndërsa certifikata përkatëse është lëshuar më 08.04.2025, rreth një vit më vonë.

Trajnimi ka qenë vetëm një ditor, ndërsa certifikata është lëshuar një vit më vonë, gjë që është absurde.

Kjo diferencë nuk përbën një çështje teknike të parëndësishme, por ngrit dyshime serioze për manipulim të mundshëm të dokumentacionit, duke rritur dyshimin për:

- autenticitetin e certifikatave;
- vlefshmërinë reale të trajnimit;
- përmbushjen e kriterëve kualifikuese të Operatorit Ekonomik të rekomanduar.

Refuzimi i ankësës dhe pretendimi i Autoritetit Kontraktues se certifikatat për Siguri dhe Shëndet në Punë janë “në rregull”, pavarësisht faktit se trajnimi ka qenë vetëm një ditor dhe certifikata është lëshuar një vit më vonë, është plotësisht i pabazuar, absurd dhe i papranueshëm. Kjo nuk përbën vetëm një mospërputhje faktike, por edhe një mosrespektim flagrant dhe të qëllimshëm të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të rregullave për përgjegjësinë e Operatorit Ekonomik.

Ky rast përfaqëson një favorizim të hapur dhe të qëllimshëm të Operatorit Ekonomik të caktuar, i cili kompromenton rëndë të gjithë procesin e Prokurimit Publik dhe cenon parimet themelore të konkurrencës së drejtë, transparencës dhe ekonomicitetit të fondeve publike.

Ky fakt, kur kombinohet me manipulimin e qartë të çmimeve në mbi 57 pozicione, tregon një strategji të mundshme për favorizim gjatë procesit të ri-vlerësimit, në kundërshtim me ligjin dhe parimet e prokurimit publik, përfshirë transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këtë kontekst, rekomandimi i këtij Operatorit Ekonomik për kontratë nga Autoriteti Kontraktues paraqet devijim serioz nga standardet ligjore dhe krijon bazë të fortë për anulimin e vendimit dhe rikthimin e procesit në një vlerësim të ligjshëm dhe objektiv.

1. Manipulim i certifikatave për Siguri dhe Shëndet në Punë
Për punonjësit me inicialet L.Z., E.R. dhe Q.R., trajnimi është mbajtur më 07.04.2024, ndërsa certifikata përkatëse është lëshuar më 08.04.2025, rreth një vit më vonë. Kjo nuk është një diferencë teknike e parëndësishme, por një manipulim i mundshëm i dokumentacionit.
2. Manipulim i çmimeve
Oferta e OE të rekomanduar përmban mbi 57 pozicione me çmime dukshëm më të larta krahasuar me çmimet e tregut dhe vlerën e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues. Ky veprim tregon një strategji të qëllimshme për të inflatuar çmimet dhe për të manipuluar procesin e vlerësimit.
3. Favorizim dhe veprime kundërthënëse nga Autoriteti Kontraktues
Pavarësisht konstatimeve të qarta të Komisionit të Vlerësimit, Zyrës së Prokurimit dhe ekspertës së OSHP-së për ofrimin e çmimeve dukshëm më të larta, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë veprime kundërthënëse, duke rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik të komprometuar. Ky veprim tregon favorizim të qëllimshëm

dhe devijim flagrant nga parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së drejtë dhe menaxhimit të fondeve publike.

Në këtë kontekst, veprimet e Autoritetit Kontraktues janë arbitrare, juridikisht të cenueshme dhe përbëjnë shkelje të rëndë të procedurës së prokurimit publik. Këto bazojnë një argument të fuqishëm për anulimin e vendimit dhe rikthimin e procesit në një vlerësim të ligjshëm, objektiv dhe të bazuar në fakte reale, duke shmangur manipulimin e dokumentacionit dhe favorizimin e paligjshëm të OE të rekomanduar.

Ky është shembull tipik i favorizimit për OE të caktuar, që kompromenton të gjithë procesin e Prokurimit Publik dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të ardhshme.

GOE i rekomanduar për kontratë është **totalisht i papërgjegjshëm** dhe është dashur të **eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit**.

Në kuadër të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), është e rëndësishme që autoriteti kontraktues të kuptojë dallimin mes vendimit për ri-vlerësim dhe një ndryshim real të rezultatit të tenderit.

Vendimi i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose të dhënies së kontratës ka për qëllim të kontrollojë nëse procedurat janë kryer në përputhje me ligjin dhe rregulloret.

Ky vendim nuk nënkupton një ndryshim të rezultatit fillestar të tenderit.

SHIH LIGJIN PËR PROKURIM PUBLIK

Neni 116 Procedurat e vendim-marrjes

6. Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Pra, Autoriteti Kontraktues duhet ta ketë të qartë se një vendim ri-vlerësimi është kontroll procedural dhe jo një vendim që automatikisht ndryshon fituesin ose listën e përzgjedhur të ofertuesve.

Si përfundim GOE i rekomanduar për kontratë është **totalisht i papërgjegjshëm** dhe është dashur të **eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit**.

Duke u bazuar në argumentet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe njëkohësisht është arsyetim blanko, duke mos e dhënë asnjë arsyetim se përse pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara. Andaj ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se **pretendimet tona ankimore janë të BAZUARA**.

Kërkojmë që të gjitha pretendimet tona të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat/vendimet e OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues NUK e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik ofertues, dhe duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit** që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

I.APROVOHET, e bazuar ankesa e OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj, Kosovë

II.OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues- MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, që të kthejë lëndën në **Ri-vlerësim** dhe me rastin e ri-vlerësimit të ofertave të rekomandohemi për kontratë ne si Operatori Ekonomik i vetmi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionin përcjellës,

- | |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">• Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundëshme,• Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet |
|---|

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*